

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
DEPARTAMENTI I KOMUNIKACIONIT**

Studimet Master



***PUNIM DIPLOME
(NIVELI MASTER)***

Kandidati:

Bsc. Përparim DRAGUSHA

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Ferat SHALA

Prishtinë, 2018

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
DEPARTAMENTI I KOMUNIKACIONIT**

Studimet Master



PUNIM DIPLOME

***Tema: “Parashikimi i aksidenteve rrugore nga
shkaktarët e tyre në Kosovë”***

***Thesis: “Road accidents prediction from their causes in
Kosovo”***

Kandidati:

Bsc. Përparim DRAGUSHA

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Ferat SHALA

Prishtinë, 2018

Përmbajtje:

I. HYRJE.....	5
II. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR AKSIDENTET KLASIFIKIMIN E TYRE	6
II.1. Aksidentet në komunikacion rrugor,	6
II.2. Ndarja dhe klasifikimi i aksidenteve,	8
II.3. Klasifikimi i aksidenteve,	9
III. AKSIDENTET DHE SHKAKTARET E AKSIDENTEVE.....	13
III.1. Shkaktarët kryesore të aksidenteve në komunikacion,	13
III.1.1. Paaftësia për ngasje,	14
III.1.2. Mospërshtatja e shpejtësisë (shpejtësia joadekuate),	15
III.1.3. Përplasja e mjetit prapa në mjetin para,	17
III.1.4. Mosrespektimi i të drejtës së përparësisë,	18
III.1.5. Mosrespektimi i ngasjes së obliguar në anën e djathtë,	19
III.1.6. Gabimet gjatë tejkalimeve,	20
III.1.7. Shkëputja nga rruga,	21
III.1.8. Gabimet gjatë kthimit, rrotullimit, ndërrimit të shiritit qarkullues dhe ngasjes prapa,	22
III.1.9. Këmbësorët si shkaktarë të aksidenteve në komunikacion,	22
III.1.10. Shkaktarët subjektiv dhe objektiv të aksidenteve,	23
IV. SHENIMET BURIMORE STATISTIKORE PËR AKSIDENTET	25
IV.1. Analiza e statistikave të aksidenteve,	25
IV.2. Pjesëmarrja sipas llojit të aksidenteve,	28
IV.3. Personat e lënduar dhe të vdekur sipas llojit të pjesëmarrësve në rrugë,	29
IV.4. Këmbësorët e lënduar dhe të vdekur sipas moshës,	30
IV.5. Aksidentet sipas llojit të rrugëve,	31
IV.6. Aksidentet sipas karakteristikave rrugore,	32
IV. 7. Faktorët kryesorë që shkaktojnë aksidentet,	33
V. METODA E PARASHIKIMIT.....	34
V.1. Metoda e parashikimit në mënyrë manuale,	34
V.2. Metoda e parashikimit përmes softuerit Excel,	36
V.3. Aksidentet me dëme material nga viti 2004-2020,	39
V.4. Aksidentet me persona të lënduar për vitin 2004-2020,	41

V.5. Aksidentet me persona të vdekur për vitin 2004-2020,	42
V.6. Personat të vdekur për vitin 2004-2020,	43
V.7. Persona të lënduar për vitin 2004-2020,	44
V.3.1. Aksidentet me dëme material nga viti 2004-2020 përmes regresionit polinomial në softuerin Excel,	48
V.4.1. Aksidentet me persona të lënduar për vitin 2004-2020,.....	52
V.5.1. Aksidentet me persona të vdekur për vitin 2004-2020,	53
V.6.1. Personat të vdekur për vitin 2004-2020,	54
V.7.1. Persona të lënduar për vitin 2004-2020,.....	55
VI. REKOMANDIMET PËR REDUKTIMIN E SHKAKTARËVE DOMINANT	58
VI.1. Krahasim i rezultateve në katër vitet e ardhshme,	58
VII. INTERPRETIMI I REZULTATEVE.....	61
VII.1. Krahasimi i aksidenteve me dëme materiale duke i interpretuar përmes rezultateve finale me metoden e regresionit,.....	61
VII.1.1 Krahasimi i aksidenteve me dëme materiale duke i interpretuar përmes rezultateve finale me regresion polinomial në softuerin Excel,,	62
VII.2. Rezultatet e aksidenteve me lëndime të shprehura me variacione,	63
VII.2.1. Rezultatet e aksidenteve me lëndime të shprehura me variacione, me regresion polinomial në softuerin Excel,	64
VII.3. Rezultatet e aksidenteve me persona të vdekur të shprehura me variacione,	64
VII.3.1 Rezultatet e aksidenteve me persona të vdekur të shprehura me regresion polinomial në softuerin Excel,	65
VII.4. Rezultatet me persona të vdekur të shprehura me variacione,	66
VII.4.1 Rezultatet me persona të vdekur të shprehura me regresion polinomial në softuerin Excel,	67
VII.5. Rezultatet me persona të lënduar të shprehura me variacione,.....	67
VII.5. Rezultatet me persona të lënduar të shprehura me regresion polinomial në softuerin Excel,	68
VII.6. Rezultatet për të gjitha finale nga viti 2004 deri 2020,.....	69
VII.6.1. Rezultatet për të gjitha finale nga viti 2004 deri 2020, me regresion polinomial në softuerin Excel,	70
VII.7. Krahasimi i rezultateve nga metoda e regresionit, me regresion polinomial në softuerin Excel,	71
VIII. PËRFUNDIMI	72
IX. LITERATURA	73

I. HYRJE

Qëllimi i kësaj teme mes tjerash është që të rangohen për nga rëndësia shkaktarëve të cilët kontribuojnë në aksidente, roli i tyre dhe ndikimi negativ në komunikacion. Në trajtimin e kësaj teme si qëllim kryesor është analiza e parashikimit të aksidenteve në Kosovë konkretisht në bazë të shënimeve statistikore nga të cilat bëhet analiza se prej cilëve shkaktar vjen më së shpeshti deri të aksidenti në komunikacion, dhe si do jete trendi i aksidenteve në të ardhmen po nga ata shkaktare potencial. Mes tjerash si qëllim kryesor është edhe nxjerrja në pah e gjendjes momentale e cila është në Kosovë, më saktësisht në zonat apo segmentet që i përfaqësojnë shënimet burimore nga të cilat do të bëhet hulumtimi. Aksidenti si term është një ngjarje mjaft e përbërë dhe e varur nga shumë shkaktarë, prandaj është e nevojshme të merren në trajtim me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve të parashikuara apo aksidenteve në rrugë.

Këto ndryshime varen në rend të parë nga shkalla e edukimit, shëndetit, moshës, temperamentit, moralit, emocioneve, inteligjencës, etj, çka edhe nga vetë ekspertët e komunikacionit vështirë mund të kuantifikohet.

Kosova si shtet i ri me sfida të shumta po zhvillon projekte të mëdha infrastrukturore në fushën e trafikut dhe transportit si dhe atë të planifikimit hapësinor.

Në kuadër të punimit tonë hulumtues shkencor me titull ” ***Parashikimi i aksidenteve rrugore nga shkaktarët e tyre në Kosovë*** ” do të japim kontributin tonë në njohjen e cila parashikohet në periudha të ardhshme se cilët janë shkaktarët me të shumtë të cilët kontribuojnë në aksidente qoftë në vend si tersi apo edhe në pika kyçe që dihen si pika të zeza apo segmente të ndryshme, po ashtu do të identifikojmë një numër të caktuar të shkaktarëve kryesor të aksidenteve, gjithnjë mbi bazën e një hulumtimi në zonën apo segmentin ku bëhet hulumtimi si i tërësishëm në Kosovë.

Punimi i masterit do të trajtohet në gjashtë kapituj ku mbi bazën e analizës dhe metodologjisë hulumtuese shkencore dhe të dhënave të cilat i nxjerrim në një pasqyrë reale të shkaktarëve të ndryshëm në Kosovë do të analizojmë efektet e këtyre si dhe faktorët relevant kryesor të sigurisë në komunikacion.

Në kapitullin e fundit do të japim rekomandimet për masat parandaluese të këtyre shkaktarëve në Kosovë.

Vlen të theksohet se problematika që do shtjellojmë është njëra ndër sfidat kryesore që ka Kosova për të zvogëluar numrin e dëmeve material dhe jo materiale që kanë një pjesëmarrje të kondisderushme në GDP e vendit.

II. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR AKSIDENTET KLASIFIKIMIN E TYRE

II.1. Aksidentet në komunikacion rrugor,

Numri i madhe i të vdekurve dhe i të lënduarve rënd në aksidentet e komunikacionit mund të shpjegohet në rend të parë si shkak i:

- ✓ Rritjes së vrullshme të numrit të mjeteve,
- ✓ Përqindjes së madhe të mjeteve të cilat qarkullojnë në gjendje jo të rregullt teknike,
- ✓ Mospnjohjes së duhur të kulturës së komunikacionit nga ana e ngasësve dhe këmbësorëve,
- ✓ Masave të dobëta parandaluese (preventive) dhe ndëshkuese për ata të cilët nuk i përfillin me përpikëri rregullat në komunikacion,
- ✓ Mospërshtatja e rrugës kushteve, trendëve dhe zhvillimeve bashkëkohore në komunikacion,
- ✓ Niveli i gjendjes dhe infrastrukturës rrugore jo i duhur, numrit të pamjaftueshëm të shenjave të komunikacionit, etj.

Aksidentet në komunikacion, posaçërisht në komunikacion rrugor, paraqesin problem esencial për çdo shoqëri. ***Me aksident në komunikacion rrugor, nënkuptohet ngjarja në rrugë, ku ka marrë pjesë më së paku një mjet në lëvizje dhe në të cilin janë lënduar ose kanë humbur jetën një apo më tepër persona, ose janë shkaktuar dëme materiale.***

Nuk është aksident i komunikacionit në rast se makina teknologjike (e punës), makina bujqësore, si p.sh. traktori, motokultivatori ose qerrja të cilat lëvizin nëpër rrugët e pa kategorizuara ose gjatë kryerjes së punëve në lëvizje ka rrëshqitur nga rruga e pa kategorizuar, ose është rrokullisur apo është ndeshur me ndonjë pengesë natyrore, gjatë të cilës nuk merr pjesë ndonjë mjet tjetër ose këmbësor dhe në këtë ngjarje personit tjetër nuk i është shkaktuar lëndim apo dëm material.

Ka raste kur në të njëjtën ngjarje së pari paraqitet incidenti e pastaj mund të pasojë edhe aksidenti, si p.sh: nëse mjeti është i parkuar përkaj rrugës, për shkaqe të panjohura, siç është era e fortë apo rrëshqitja, mjeti rrokulliset dhe bien në një pjesë më të ulët apo në kanal, atëherë kjo klasifikohet si incident, mirëpo nëse më vonë ngasësi kërkon kamionin tërheqës, i cili gjatë tërheqjes nga kanali i shkakton dëm mjetit apo shkaktohet ndonjë lëndim, atëherë bëhet fjalë për aksident komunikacioni.

Prandaj, për të qenë aksident komunikacioni duhet të plotësohen këto kushte:

- Kushti i parë dhe kryesor është që së paku një mjet duhet të jetë në lëvizje, pra nëse mjeti nuk është në lëvizje, por është i parkuar, ndërsa në të hedhet ndonjë objekt, atëherë trajtohet si incident,
- Kushti tjetër themelor është që mjeti të lëvizë në rrugën e destinuar për qarkullimin e mjeteve në komunikacion dhe si pasojë e ngjarjes mund të ketë të vdekur, të lënduar apo edhe dëme materiale.

Aksidentet në përgjithësi për nga pasojat klasifikohen në tri kategori:

I. Aksident fatal (vdekjeprurës) quhet ai aksident i komunikacionit që pas goditjes – kontaktit ndërmjet mjeteve, apo mjetit më ndonjë objekt ose subjekt, që si pasojë e goditjes – kontaktit, shkaktohet vdekja e njeriut (subjektit).

II. Aksident i rëndë i komunikacionit – quhet ai aksident në të cilin, me rastin e goditjes - kontaktit ndërmjet mjeteve, apo të mjetit në lëvizje në ndonjë objekt ose subjekt shkaktohet lëndim i rëndë i natyrës trupore apo edhe dëm i madh material.

III. Aksident i lehtë i komunikacionit – quhet ai aksident në të cilin, me rastin e goditjes – kontaktit ndërmjet mjeteve, apo të mjetit në lëvizje në ndonjë objekt apo subjekt shkaktohet lëndim i lehtë i natyrës trupore apo edhe dëm i vogël material.

Dëm i vogël material në aksidentin e komunikacionit është dëmi i shkaktuar objekteve dhe mjetit, të cilit nuk u janë dëmtuar pjesët vitale për drejtim dhe frenim, ndërsa mjeti mundet vet të lëviz nëpër rrugë. Këto dëme vlerësohen në vlerë deri në 15.000€.

E kundërta, kur mjetit i janë dëmtuar pjesët vitale për drejtim dhe frenim ose të tjerat, ndërsa mjeti nuk mund të lëviz vet nëpër rrugë, kemi rastin e aksidentit me dëm të madh material. Ndërsa, këto dëme vlerësohen edhe në vlerë mbi 15.000€.

Aksidentet e lehta të komunikacionit nuk shkaktojnë pasoja të mëdha dhe nuk janë të rrezikshme, prandaj në përgjithësi klasifikohen si kundërvajtje, e jo si vepër penale, ndërsa aksidentet e rënda dhe fatale të komunikacionit klasifikohen si vepra penale dhe si të tilla ndiqen penalisht, por gjithashtu kanë edhe përgjegjësi civile për shkak të demit material të shkakuar. Palët e dëmtuara në këto aksidente mund t'i drejtohen gjykatës me kërkesë për kompensimin e dëmeve të pësuar, si çështje civile.

Përpos definimit të theksuar më lartë lidhur me aksidentin rrugor, ekziston edhe ky definim: aksident rrugor – është një ngjarje e verifikuar në rrugë ose në hapësira të hapura për qarkullim, në të cilën janë përfshirë mjete ku së paku njëri nga ato është në lëvizje, njerëz ose kafshë, që nuk lëvizin ose janë në lëvizje, dhe prej të cilës rrjedhin këto pasoja:

- Vdekje njerëzish,
- Të paktën një plagosje,
- Dëmtime materiale.

II.2. Ndarja dhe klasifikimi i aksidenteve,

Aksidentet në komunikacion rrugor ndahen sipas:

- Kohës në të cilën aksidenti ka ndodhur (periudhës, stinës, muajit, ditës, së javës, ditës apo natën, në orë të caktuara të ditës: faza e parë ora 06 – 10, faza e dytë ora 11 – 14, faza e tretë ora 15 – 18, faza e katërt ora 19 – 22, faza e pestë ora 23 – 06),
- Vendit në të cilin aksidenti ka ndodhur (në vendbanime ose jashtë vendbanimeve, zonës), karakteristikave të rrugës (llojit, destinimit, gjerësisë, pjerrtësisë, llojit të asfaltit, gjendjes së rrugës, etj.),
- Mënyrës sipas së cilës aksidenti ka ndodhur (ndeshjet reciproke, goditja në mjetin e parkuar ose objektet e rrugës, rrotullimi ose dalja e mjetit na rruga, goditja dhe shkelja e këmbësorëve, rënie e personit nga mjeti dhe aksidente të tjera),
- Shkakut nga i cili ka ndodhur aksidenti (gabimi i ngasësit, mangësitë në rrugë gjendja jo e rregullt teknike e automjetit, gabimi i këmbësorit, gabimi i udhëtarit),
- Pasojave (të vdekur, rëndë të lënduar, lehtë të lënduar ose vetëm me dëme materiale).

Pos këtyre ndarjeve aksidentet mund të ndahen edhe sipas:

- Pjesëmarrësve në komunikacion,
- Grup – moshës, vjetërsisë si ngasës i mjetit, gjinisë, përgatitjes shkollore, profesionit, gjendjes familjare,
- Përsëritjes së veprës e cila e ka shkaktuar aksidentin, etj.

II.3. Klasifikimi i aksidenteve,

Nisur nga dinamika e tyre, aksidentet mund të klasifikohen edhe si: Ndeshje, Goditje, Përplasje (shtypje), dhe humbje drejtimi:

a) Ndeshja

Ndeshja ndodh atëherë kur çfarëdo mjeti në lëvizje (ecje) përballet me një mjet tjetër në lëvizje. Ndeshja mund të jetë ballore ose anësore dhe përplasje të mjeteve që ndodhen njeri pas tjetrit, pra dy mjete që lëvizin me kah të njëjtë, por me shpejtësi të ndryshme.



Fig.1. Ndeshja ballore e automjeteve.¹

¹ <http://www.thegeorgialawyer.com/new-rule-requires-rear-visibility-technology-in-cars/>

b) Goditja

Goditja ka të bëjë me ndeshjen e fortë ndërmjet të një mjeti në lëvizje me një të ndalur (në qetësi).




Fig. 2. Ndeshja e automjeteve kur mjeti para tij është në qetësi.

c) Përplasja (shtypja)

Përplasja është shtypja e një këmbësori, një çiklisti, një motoçiklisti ose një mjeti të tërhequr me kafshë me një mjet në lëvizje.



Fig. 3. Përplasja e motoçiklistit nga auto.² Fig. 4. Përplasja e këmbësorit nga auto.

² <http://www.thegeorgialawyer.com/new-rule-requires-rear-visibility-technology-in-cars/>



Fig. 5. Përplasja e çiklistit nga automjeti.

d) Goditja e objektit

Goditja e objektit është ai rast kur një mjet përplaslet me një pengës fikse.



Fig. 6. Përplasja e automjetit me pengesa fikse.³

³ <http://www.thecarexpert.co.uk/uk-road-accident-statistics/>

e) Humbja e drejtimit

Humbja e drejtimit është lëvizja e pakontrolluar e mjetit që për shkak të rrëshqitjes ose për shkaqe tjera, nuk i bindet me atij që e drejton.



Fig. 7. Humbja e drejtimit mbi automjetin përgjatë lëvizjes.⁴

⁴ <http://www.thecarexpert.co.uk/uk-road-accident-statistics/>

III. AKSIDENTET DHE SHKAKTARET E AKSIDENTEVE

III.1. Shkaktarët kryesore të aksidenteve në komunikacion,

Aksidentet në komunikacion paraqiten si pasojë e shumë faktorëve të cilët janë të lidhur mes veti. Vlerësimet statistikore kryesisht janë të kufizuar në shkaktarin e parë dhe të dytë e nganjëherë edhe në shkak-tarin e tretë.

Sipas hulumtimeve të bëra në ish Gjermaninë Perëndimore, shkak-tarë më të shpeshtë të aksidenteve në komunikacion janë:

1. Paaftësia për ngasje,
2. Mospërshtatja e shpejtësisë (shpejtësia joadekuate),
3. Përplasja e automjetit prapa në automjetin para,
4. Mosrespektimi i të drejtës së përparësisë,
5. Mosrespektimi i ngasjes (lëvizjes) së obliguar në anën e djathtë,
6. Gabimet gjatë tejkalimeve,
7. Shkëputjet nga rruga,
8. Gabimet gjatë kthimit, rrotullimit, ndërrimit të shiritit qarkullues dhe ngasjes prapa,
9. Këmbësorët si shkaktar të aksidenteve në komunikacion.

Numri i aksidenteve në komunikacion brenda ditës rritet krahas rritjes së dendësi së komunikacionit. Komunikacion i aksidenteve kryesisht arrin ndërmjet orëve 12-20, diku rreth 50% të aksidenteve. Në këtë pjesë të ditës më së shumti aksidente ndodhen në kohën e komunikacionit kulmor. Prej aksidenteve në komunikacion të cilët ndodhin brenda ditës, më të theksuara janë këto tipe të aksidenteve: përplasja nga ana e automjetit prapa në automjetin para, mosrespektimi I përparësisë, gabimet gjatë kthimit ndërrimet të shiritit qarkullues dhe ngasja prapa.

Ndërsa brenda natës llojet më të shpeshta të aksidenteve në komunikacion janë për shkak të:

- Mospërshtatjes së shpejtësisë,
- Shkëputjes nga rruga, si dhe
- Gabimit gjatë tejkalimit.

Prej numrit të përgjithshëm të aksidenteve në komunikacion më tepër se 60% ndodhin gjatë ditës. Sipas disa të dhënave më së tepërmi aksidente brenda javës ndodhin gjatë të premtëve dhe shtunave (në fund të javës punuese), ndërsa numri i aksidenteve bie gjatë të hënave dhe martave (në fillim të javës, pas pushimit të vikendit).

Gjatë vitit, më së tepërmi aksidente në komunikacion ndodhin gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht për shkak të fluksit më të madh të njerëzve në sezonin turistike.

III.1.1. Paaftësia për ngasje,

Paaftësia për ngasje ndodhë për shkak të marrjes së alkoolit, narkotikëve, barnave, stërlodhjes etj. Komunikacioni rrugor kërkon prej çdo pjesëmarrësi në komunikacion aftësi të duhura psikofizike, pasi që vetëm zvogëlimi i vogël i kujdesit (vëmendjes, reagimit) dhe mos përqendrimit të duhur, shpie deri te aksidenti në komunikacion.

Gjatë shqyrtimit të aftësive të ngasësit duhet të merren parasysh të metat fizike dhe mendore të tij. Përshtypja e jashtme nuk përmban gjithmonë gjendjen reale shpirtërore dhe fizike, sepse ajo dukshëm mund të ndryshojë nga “shoku” i cili pason si pasojë e aksidentit në komunikacion psh. Ngasësi i lodhur mund të përshtypjen e ngasësit të “freskët” ndërsa i dehuri të lë përshtypjen e ngasësit jo të dehur.

Stërlodhja është një shkaktar shumë më i shpeshtë i aksidenteve në komunikacion, se sa atë e tregojnë të dhënat statistikore, pasi që si e tillë, lodhja gjithmonë nuk mund të dëshmohet. Stërlodhja mund të pasqyrohet me simptome të ndryshme: vështirësia e lëvizjes së qepallave të syrit, mbyllja e shpeshtë e syve, kotja, fotografia e dyfishtë, reagimi i ngadalësuar, me ç’rast humb ndjeshmëria (sensi) për shpejtësinë dhe dobësohet koncentrimi.

Një ndër shkaktarët që dukshëm zvogëlojnë aftësitë e ngasësit është alkooli i cili ka ndikim të madh në shkaktimin e aksidenteve në komunikacion. Ndikimi i alkoolit zvogëlon ndjenjat për rend dhe disiplinë, ndërsa nxit agresivitetin te pjesëmarrësit në komunikacion. Problem sekondar i ngasësit nën ndikimin e alkoolit, paraqet gatishmërinë e tij për rrezik, me të cilën gatishmëri edhe një pjesë e ngasësve jo të dehur marrin pjesë në komunikacion. Sot çdo i pesti person që ka humbur jetën gjatë aksidentit në komunikacion ka lidhje me konsumimin e alkoolit. Probabiliteti që ngasësi të shkaktoj aksidentin i cili në gjak ka koncentrik të alkoolit prej 0.5% është tri herë më i madh se sa te ngasësit të cilët nuk kanë konsumuar alkool. Një mundësi e tillë rritet për katër herë më shumë, nëse koncentrimi i alkoolit në gjak arrin në 0.8%. Një sasi vogël e alkoolit mund të zgjasë kohë e reagimit dhe zvogëlon vetë kontrollimin mbi automjet dhe gjendjen në rrugë.

Gabimet më të theksuara të pjesëmarrësve në komunikacion të cilët janë nën ndikimin e alkoolit janë:

- Tejkalimi i pakontrolluar i shpejtësisë,
- Prerja e kthesave,
- Ngasja “cik-cake” e automjetit,
- Frenimi i vrullshëm,
- Mosrespektimi i shenjave në trafik,
- Mos aplikimi i dritave sipas rregullave për ndriçim gjatë natës.

Ngasësit nën ndikimin e barërave dhe narkotikëve, gjithashtu janë shkaktar të shumë aksidenteve në komunikacion. Është vështirë, gjatë aksidentit të ndodhur, të përcaktohet nëse është ngasësi nën ndikimin e barërave apo të narkotikëve. Ngasësi nën ndikimin e narkotikëve nuk ka kurrfarë kontrole mbi vetveten dhe gjendjen në trafik.

Konsumimi i alkoolit pas përdorimit të barnave ose narkotikëve, dukshëm dobëson aftësitë e ngasësit. Një kombinim i tillë mund të shkaktojë reagime intensive dhe anormale, si dhe zgjatjen e ndikimit të alkoolit në organizëm.

III.1.2. Mospërshtatja e shpejtësisë (shpejtësia joadekuate),

Mospërshtatja e shpejtësisë kushteve dhe rrethanave në komunikacion, shpesh vlerësohet si shkaktari kryesor i aksidenteve. Aksidentet e rënda të cilat ndodhi si rezultat i mospërshtatjes së shpejtësisë, klasifikohen në tri lloje të aksidenteve, që ndodhin gjatë:

- Tejkalimeve,
- Përplasjes prapa,
- Shkëputjes nga rruga.

Shpejtësia e ngasjes varet edhe nga kushtet e dukshmërisë (vizibilitetit). Ky parim themelor vlen për të gjitha rrugët, gjatë ditës e natës, dhe gjatë të gjitha kushteve klimatike. Gjatë natës, ngasësi është i detyruar të rregullojë shpejtësinë e automjetit në mënyrë që brenda largësisë së hedhjes së dritave të reflektorëve, të ketë kohë të mjaftueshme për ndalje. Ndikim të rëndësishëm për zgjedhjen e shpejtësisë kanë kushtet klimatike (bora, mjegulla, shiu, etj), si dhe vjetërsia e rrugëve. Nëse rrugët janë të lagëta ose me akull, ngasësi duhet ta ketë parasysh që rruga e ndaljes është më e gjatë.

Motivet e ngasësve për zgjedhjen e shpejtësisë së automjetit janë të ndryshme. Ato shpesh mund të jenë imagjinatë e tepruar si dhe kënaqje e agresivitetit. Shpejtësia mesatare kohëve të fundit është rritur me ndërtimin e rrugëve më të mira dhe me përmirësimin e kushteve teknike të ngasjes (automjetet bashkëkohore me elemente antikolizive të sigurisë). Ngasja e automjeteve pa goditje dhe zhurmë të theksuar i jep mundësi ngasësit që më lehtë ta humbë ndjeshmërinë mbi shpejtësinë. Më tepër se gjysma e aksidenteve ndodhin në vendbanime, dmth, në vendet ku shpejtësia e ngasjes është e kufizuar në 50-60km/h. Te llojet e caktuara të aksidenteve, psh, kthimi i drejtimit nga rruga kryesore në atë të rendit të dytë, gjatë kthimit dhe lëvizjes prapa, shpejtësisë gjithashtu janë të vogla, ndërsa aksidentet prapë janë të shpeshta.

Shpejtësitë e mëdha kanë një ndikim të veçantë te aksidentet që ndodhin gjatë tejkalimeve, përplasjes, mosrespektimit të ngasjes nëpër shiritin e djathtë qarkullues dhe gjatë shkëputjes nga rruga. Nga ngasësi kërkohet që të zhvilloj shpejtësi, gjatë së cilës do t'i përmbushte obligimet e veta, por të mos i rrezikojë pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion. Gjatë kohës së ngasjes, ngasësi gjithmonë duhet të ngasë automjetin me shpejtësi të përshtatur.

Ngasësi sipas situatave që i krijohen gjatë udhëtimit, duhet të zgjedhë atë shpejtësi të lëvizjes së mjetit që siguron udhëtime pa rreziqe.

Në çdo rast shpejtësia e lëvizjes zgjidhet sipas:

- Gjendjes së rrugës dhe sipërfaqes së saj,
- Gjendjes teknike të mjetit dhe ngarkesës së tij,
- Mundësisë për të parë qartë objektet që ndodhen mbi rrugë ose në mjedisi për rreth, pozicionin e mjeteve tjera në rrugë, komunikacionin (trafikun), si dhe çdo rrethanë tjetër të çdo natyre,
- Mundësisë së shmangies nga çdo rrezik për sigurinë e njerëzve dhe mallrave dhe nga cili do shkak tjetër që krijon çrregullime për trafikun.

Gjithashtu ngasësi i mjetit nuk duhet të zvogëloj shpejtësinë e lëvizjes së mjetit deri në atë masë, sa që t'i shkaktojë pengesë zhvillimit normal të qarkullimit rrugor.

III.1.3. Përplasja e mjetit prapa në mjetin para,

Shkaktari kryesor i përplasjes së mjetit prapa në atë para është distance jo e duhur e sigurisë ndërmjet mjeteve në lëvizje. Numri i aksidenteve të tilla rritet me rritjen e dendësisë dhe më së tepërmi janë të pranishme në qytetet e mëdha gjatë komunikacionit kulmor.

Këto lloje të aksidenteve kanë pasoja shumë të rënda, nëse ndodhin në rrugët e rangut më të lartë psh, rrugët magjistrale dhe auto rrugë (autostradë) ku shpejtësia e qarkullimit është e madhe.

Gjatë qarkullimit një kahorë, paraqitet rreziku që mjeti prapa të përplasët në mjetin para, sepse përdoret shiriti i njëjtë qarkullues. Ngasësit e mjeteve aplikojnë shpejtësi të ndryshme të ngasjes dhe kanë qëndrime të ndryshme të arrijnë në destinacionin përkatës , ndërsa mundësitë që njëri-tjetrin me kohë ta njoftojnë për manovrimet e tyre, janë të kufizuara.

Rreziku i përplasjes në mjetin para rritet me rritjen e dendësisë së komunikacionit edhe për shkak të këtyre rrethanave:

- Ngasësi i mjetit para e pamundëson dukshmërinë e duhur të mjetit prapa dhe ngasësi i mjetit para shpesh me vonesë e vëren situatën e krijuar në trafik, e cila ngasësin e para e ka detyruar që të frenojë vrullshëm ose të ndalet,
- Mjetet e ndryshme, sipas llojit, gjendjes dhe kushteve të krijuara në rrugë, kanë rrugë të ndryshme të frenimit dhe të ndaljes, me të cilën pjesëmarrësit në trafik më parë nuk janë të njohur,
- Mënyra e ngasjes, kujdesi dhe aftësia e reagimit janë ndryshme të ngasësit e mjeteve.

Ngasësi i mjetit prapa mund të evitoj rrezikun e përplasjes me mjetin para vetëm nëse e mban distance e duhur të sigurisë. Distanca e sigurisë përcaktohet në bazë të kohës së reagimit dmth, kohës së nevojshme që ngasësi ta vërejë rrezikun dhe ta aktivizoj frenin. Në bazë të hulumtimeve të bëra koha e reagimit është 1.5 sekonda. Gjatë ngasjes duhet përmbajtur rregullave për distancën e sigurisë e cila varet nga shpejtësia dhe koha e reagimit prej 1.5 sekonda. Nganjëherë është e mundur që ngasësi i mjetit prapa të zvogëlojë përgjysmë distancën e sigurisë (nëse dëshiron të tejkalojë), mirëpo është e nevojshme që ky shkurtim i përkohshëm i distancës së sigurisë të mos zgjasë më tepër se 300 metra. Kjo distancë minimale, e cila nuk guxon të shfrytëzohet në gjatësi më tepër se 300 metra, fitohet në atë mënyrë që koha e reagimit merret 0.8 sekonda.

Si ndihmë për orientim ngasësve, gjatë zgjedhjes së distancës së sigurisë, preferohet që koha e reagimit të merret 1.8 sekonda dhe në atë rast distanca e sigurisë e shprehur në metra është 0.5 V (ku V paraqet shpejtësinë në km/h). Me distancën e tillë mund të evitohet përplasja në mjet para edhe në qarkullimi zhvillohet në kushte mjaft të vështira.

Si shkak i përplasjes së mjetit prapa në mjetin para për shkak të distancës të mjaftueshme të sigurisë, sipas hulumtimeve të bëra në ish Gjermaninë Perëndimore janë theksuar këto arsye në përqindje:

- Mospërshtatja e shpejtësisë 31.6%,
- Kujdesit jo i mjaftueshëm 37.0%,
- Mos përfillja e kushteve në rrugë 6.9%,
- Zvogëlimi i dukshmërisë si rezultat i kushteve klimatike 6.5%,
- Gabime tjera 6%,
- Rrethanat e tjera të cilat pamundësojnë dukshmërinë 2.8%,
- Të verbuarit me drita nga mjeti i cili lëvizë në shiritin e kundërt qarkullues ose nga dielli 2.7%,
- Vendet e padukshme 2.2%,
- Mangësitë në mjet 1.6%.

Për shkak të gjendjes jo të rregullt teknike, përplasja e mjetit prapa në atë para është si rezultat i frenave të dobët ose gomave të harxhuara.

Shumica e ngasësve të cilët shkurtojnë distancën e sigurisë, e bëjnë këtë pa vetëdije, pasi që nuk kanë njohuri të duhura për faktorët e rrezikut të cilët janë shkaktarë vendimtarë në ndodhjen e aksidentit në komunikacion e sidomos për përplasjen në mjetin para.

III.1.4. Mosrespektimi i të drejtës së përparësisë,

Aksidentet në komunikacion të cilat ndodhin si rezultat i mosrespektimit të së drejtës së përparësisë i paraprinë situatë konfliktuoze e krijuar ndërmjet mjetit cili kthehet duket prerë tërthorazi rrugën, mirëpo ka qenë i detyruar të pres mjetin i cili ka pasur të drejtë përparësie. Llojet e tilla të aksidenteve kryesisht ndodhin në vendbanime ku dendësia e qarkullimit është e madhe, veç qenërisht në udhëkryqe ku e drejta e përparësisë është e rregulluar me shenja të trafikut.

Pastaj, pasojnë udhëkryqet dhe fytet e ngushta të rrugës në të cilat vlen rregulla, i djathti ka përparësi ndaj të majtit”, si dhe udhëkryqet me semaforë.

Është karakteristik numri i madh i aksidenteve në fyte të ngushtë të rrugës dhe udhëkryqe në të cilat është i lejuar edhe qarkullimi i biçikletave dhe motoçikletave, të cilët kanë pasur të drejtën e përparësisë, ndërsa te automjetet komerciale numri i aksidenteve është dukshëm më i vogël nga pjesëmarrja e tyre në komunikacion.

Në bazë të dhënave statistikore, gabimet më të theksuara të ngasësve të cilët nuk i kanë respektuar të drejtën e përparësisë, të shprehura në përqindje janë:

- Me vonesë vërejnë mjetin i cili ka përparësi kalimi 52.6%,
- Nuk e kanë vërejtur situatën që dikush ka përparësi kalimi 14.8%,
- Kanë nënvlerësuar shpejtësinë dhe largësinë e mjetit i cili afrohet 10.7%,
- Me vonesë janë orientuar 9.2%,
- Nuk janë ndalur me shenjën STOP 7.4%,
- Me gjithë dukshmërinë e kufizuar dhe situatën e padukshme, kanë hyrë pa kujdes në udhëkryq 7.1%,
- Në mënyrë të përshpejtuar iu kanë afruar udhëkryqit ose fytit të ngushtë të rrugës dhe nuk kanë mundur me kohë të reagojnë 5.3%,
- Kanë hyrë në udhëkryq gjatë dritës së kuqe në semafor 3.5%,
- Kanë menduar se kanë përparësi kalimi 3.2%,
- Kanë hyrë në udhëkryq gjatë dritës së verdhë në semafor 1.1%,

III.1.5. Mosrespektimi i ngasjes së obliguar në anën e djathtë,

Ngasja e obliguar e mjeteve në anën e djathtë bënë pjesë ndër rregullat më të rëndësishme të trafikut rrugor.

Me shfrytëzimin e vetëm njërës anë të rrugës dukshëm lehtësohet qarkullimi në komunikacion gjatë shfrytëzimit optimal të hapësirës së komunikacionit, ndërsa njëkohësisht rritet siguria me fiksimin dhe shënjimimin e shiritave qarkullues në mënyrë që të fitohet hapësira e sigurt.

Numri i këtyre llojeve të aksidenteve rritet me rritjen e dendësisë së qarkullimit në komunikacion. Sipas hulumtimeve të bërë në Gjermaninë Perëndimore, ndër shkaqet e aksidenteve në komunikacion, me ç'rast mjeti ka arritur të depërtoj shumë në anë e majtë të rrugës, janë theksuar:

- Shpejtësia e papërshtatur, me ç'rast ngasësi humb kontrollin mbi mjetin 44.7%,
- Kushtet klimatike në rrugë 28.08%,
- Moskujdesi 12.8%,
- Ngasësi gjatë ngasjes së mjetit besohet të ketë fjetur 2.7%,
- Gjendja jo e rregullt teknike e mjetit 2.2%.

Nëse ngasësi gjendet në kthesë në anën e majtë të rrugës pa dëshirën e tij, do të thotë se ai ka bërë gabim në zgjedhjen e shpejtësisë ose gjatë manipulimit me mjet. Kushtet atmosferike (shiu, akulli, bora, mjegulla) dukshëm ndikojnë në rritjen e aksidenteve të këtij lloji. Përveç shkaktarëve të përmendur në mosrespektimin e ngasjes së detyruar në anën e djathtë të rrugës, ndikim të theksuar kanë edhe vendet e ngushtuara në rrugë, pjerrtësia e rrugës, pjesët e rrugëve me dukshmëri të zvogëluar, gjendja e trasesë së rrugës, etj. Aksidentet e shkaktuara si rezultat i mosrespektimit të ngasjes së detyruar në anën e djathtë të rrugës kanë si pasojë shumë viktima në komunikacion. Deri te këto lloje të aksidenteve vijnë për shkak se situatat e rrezikshme paraqiten në mënyrë të befasishme dhe personat e rrezikuar nuk janë në gjendje që të reagojnë me kohë.

III.1.6. Gabimet gjatë tejkalimeve,

Aksidentet të cilat ndodhin gjatë tejkalimeve të mjeteve shpesh mund të jenë me pasoja fatale. Rastet më të rënda ndodhin jashtë vendbanimeve, dmth, në rrugët e hapura të cilat ngasësve iu mundësojnë që të zhvillojnë shpejtësi të mëdha. Sipas hulumtimeve të bëra tejkalimet e gabuar janë:

- Përkundër komunikacionit nga drejtimi i kundërt 29.3%,
- Para udhëkryqeve dhe rrugëve të ngushtuara 13.8%,
- Përkundër rrethanave tjera të cilat e pengojnë tejkalimin 13,1%,
- Gjatë kalimit të vonuar në anë e majtë të rrugës 9,4%,
- Para kthesave të padukshme 8.8%,
- Në vendet tjera të padukshme 4.0%,
- Në mënyrë të palejuar djathtas 3.4%,
- Si tejkalues i dyfishtë 2.7%,
- Në mënyrë jo të mjaftueshme majtas 2,4%,

Gabimet më të shpeshta gjatë tejkalimeve shkaktohen, sepse ngasësi e nënvlerëson fluksin e qarkullimit dhe kohën e ngasjes ose vonë e vëren se po afrohet mjete i cili lëviz nga ana tjetër e rrugës.

Gjatë tejkalimeve duhet që të jetë e dukshme një pjesë më e madhe e rrugës se sa ajo që është e nevojshme për tejkalim. Rreziku i mëtutjeshëm paraqitet gjatë tejkalimeve në hapësirën e udhëkryqeve ose në pjesët e ngushtuara të rrugës. Te tejkalimet e tilla ekzistojnë edhe dy faktorë plotësues që paraqesin rrezik:

- Mundësia e kufizuar e orientimit lidhur me qarkullimin eventual të tërthortë dhe
- Mundësia eventuale që mjete të cilin ngasësi dëshiron ta tejkalojë të kthehet majtas.

III.1.7. Shkëputja nga rruga,

Numri më i madh i aksidenteve ku vjen deri te shkëputja e mjetit nga rruga, vijnë nga gabimi i ngasësit, pa ndikim i pjesëmarrësve tjerë në qarkullim. Në një numër të vogël të aksidenteve të këtij lloji mund të jetë manovrimi i ngasësit për ti ikur ndeshjes së mjetit tjetër ose pengesave tjera. Më shumë se 65% të këtyre aksidenteve ndodhin jashtë vendbanimeve. Në bazë të shënimeve statistikore aksidentet gjatë shkëputjes nga rruga ndodhin:

- Në kthesa 60.2%,
- Në rrugë të drejtë 32.8%,
- Në rrugën me pjerrtësi 5.0%,
- Të tjera 2.0%,

Shkëputjet djathtas të mjetit nga rruga janë 56.6%, ndërsa në anën e majtë të rrugës 43.4% të mjeteve.

Shkaktarët që ndikojnë në shkëputjen nga rruga mund të merren:

- Mospërshtatja e shpejtësisë,
- Kushtet klimatike dhe rrugore,
- Mangësitë (gjendja jo e rregullt teknike) në mjet,
- Besueshmëria që ngasësi ka fjetur,
- Manovrimi për skajim ose evitim të ndeshjes,
- Mjete tjetër,
- Bisha (egërsia) apo kafsha në rrugë,
- Pengesat në rrugë,
- Këmbësori dhe biçiklisti.

Shënime statistike gjithashtu tregojnë se në aksidentet e shkëputjes nga rruga ndikojnë mosha dhe aftësitë e ngasësit. Më shumë se 75% të këtyre aksidenteve e shkaktojnë ngasësit që e kanë patentën e shoferit më pak se tre vjet.

Kushtet klimatike (shiu, bora, akulli, mjegulla, etj) kanë ndikim të madh në shkaktimin e këtyre aksidenteve. Gjithashtu shpejtësia e ngasjes më e madhe se 80km/h e lehtëson shkëputjen nga rruga, e me këtë edhe e rritë mundësinë e aksidenteve.

Te të gjitha llojet e aksidenteve, çdo i 15-ti ngasës ka qenë në ndikimin e alkoolit, ndërsa te aksidentet nga shkëputja nga rruga çdo i 4-ti ngasës.

III.1.8. Gabimet gjatë kthimit, rrotullimit, ndërrimit të shiritit qarkullues dhe ngasjes prapa,

Numri më i madh i aksidenteve gjatë kthimit, rrotullimit, ndërrimit të shiritit qarkullues dhe ngasjes prapa ndodhin në vendbanime. Gjatë lëvizjes me shpejtësi më të vogla se 50km/h krijohen situata të rrezikshme, kurse gjatë këtyre shpejtësive aksidentet më të shpeshta ndodhin gjatë shpejtësive më të vogla se 25km/h.

Ndikim më të madh në këto aksidente kanë këto raste: kthimi në të majtë, ngasja në hyrje dhe dalje të rrugës, kthimi në të djathtë, rrotullimi, ndërrimi i shiritit të qarkullimit etj.

Në bazë të hulumtimeve të bëra pjesëmarrja e rasteve të aksidenteve e shprehur në përqindje është:

- Kthimi në të majtë 42.8%,
- Ngasja në hyrje dhe dalje të rrugës 31.0%,
- Kthimi në të djathtë 10.1%,
- Rrotullimi 8.3%,
- Ndërrimi i shiritit të ngasjes 7.8%,

III.1.9. Këmbësorët si shkaktarë të aksidenteve në komunikacion,

Në bazë të hulumtimeve që janë bërë në Gjermaninë Perëndimore këmbësorët kanë shkaktuar 26,1% të aksidenteve në komunikacion. Prandaj, duhet ndikuar në vetëdijen e këmbësorëve lidhur me përgjegjësinë dhe rëndësinë që kanë këmbësorët si pjesëmarrës në komunikacion. Në anë tjetër duhet të ndërtohet ose rindërtohen rrugët në të cilat si këmbësori ashtu edhe pjesëmarrësit tjerë në komunikacion janë më të sigurve.

Duhet pasur parasysh se në kuadër të këmbësorëve mund të ketë persona me të meta mendore dhe fizike, prandaj çdo ngasës duhet të ketë kujdes të madh ndaj këmbësorit.

Në bazë të shënimeve statistikore aksidentet me këmbësorë ndodhin:

- Në vendkalimet e këmbësorëve 9.8%,
- Në hapësirën e udhëkryqit ose në fytet e ngushta të rrugës 6.3%,
- Në rrugë 63.3%,
- Në ishuj në hyrje të udhëkryqit 5.7%,
- Jashtë rrugës 3.6%,

Numri I këmbësorëve të aksidentuar sipas moshës së tyre:

- Deri në moshën 5 vjeçare 15.9%,
- Prej moshës 6-17 vjeçare 31.9%,
- Prej moshës 18-24 vjeçare 5.6%,
- Prej moshës 25-44 vjeçare 13.0%,
